

VENDIM
Nr. 1106, datë 24.12.2020

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË MENTORIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV
TË SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005, "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimi financiar i mentorit në strukturat e linjës informative-operative në Shërbimin Informativ të Shtetit është në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.
 2. Kur mentori ka nën kujdes më shumë se 1 (një) punonjës në periudhë prove, trajtimi financiar mujor nuk e kalon masën totale mujore të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
 3. Mentori nuk përfiton trajtim financiar në rast zgjatjeje të afatit të periudhës së provës për punonjësën që ka nën kujdes.
 4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin Informativ të Shtetit.
 5. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe